**RAPORT I DEPARTAMENTIT TË SHTETIT TË SH.B.A.**
**MBI TË DREJTAT E NJERIUT**

# SHQIPËRIA 2005

Shqipëria është një demokraci parlamentare me një popullsi rreth 3.2 milion banorë. Pushteti legjislativ mbahet nga Kuvendi Popullor (parlamenti) njëdhomësh, i cili zgjedh si kryeministrin ashtu edhe presidentin. Kryeministri kryeson qeverinë, ndërsa presidenca është një post kryesisht ceremonial me fuqi të kufizuar ekzekutive. Zgjedhjet parlamentare të mbajtura në korrik nuk përmbushën plotësisht standardet ndërkombëtare dhe u shënuan nga llogaritje të stërzgjatura të rezultateve, por në përgjithësi, u konsideruan një hap përpara në zhvillimin demokratik të vendit. Autoritetet civile përgjithësisht kishin kontroll efektiv mbi forcat e sigurisë.

Qeveria përgjithësisht respektoi të drejtat e njeriut për shtetasit e saj. Megjithatë, ka patur probleme serioze në disa fusha. Problemet e mëposhtme të të drejtave të njeriut janë raportuar:

- Rrahja nga policia dhe abuzimi me të dyshuarit, të ndaluarit dhe të burgosurit
- Kushtet e këqija në burgje
- Arrestimi dhe ndalimi arbitrar
- Paraburgimi i zgjatur
- Korrupsioni dhe mosdënimi i policisë
- Dhunimi mbi të drejtat e jetës private të qytetarëve
- Politizimi i medias
- Përdorimi rastësor i forcës policore kundër protestuesve
- Vrasjet në shoqëri dhe një atmosferë frike në disa zona për shkak të gjakmarrjeve tradicionale
- Dhuna në shoqëri dhe diskriminimi kundër grave dhe fëmijëve
- Trafikimi i njerëzve
- Diskriminimi në shoqëri kundër Romëve, Egjiptianëve dhe homoseksualëve
- Puna e fëmijëve

## RESPEKTIMI PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Seksioni 1 Respekti për tërësinë e personit, përfshirë lirinë nga

a. Privimi arbitrar apo i jashtëligjshëm i jetës

Qeveria ose agjentët e saj nuk kryen ndonjë vrasje të motivuar politikisht.

Nga fundi i vitit, nuk pati zhvillime mbi apelimet e dy rojeve të policisë të dënuar në lidhje me vrasjen e shkaktuar nga rrahja në korrik 2004 të Erigert Cekës, ndërkohë që ai ishte në paraburgim. Në 2004, një gjykatë dënoi një roje me gjashtë muaj burgim për shkak të kryerjes së veprimeve arbitrare, ndërkohë që shoqëronte të paraburgosur dhe rojen e dytë me tetë muaj burgim për shkelje të rregullave të shërbimit të rojes sipas Kodit Ushtarak dhe shpërdorimit të detyrës. Gjykata nuk mbajti asnjë person drejtpërdrejt të përgjegjshëm për vdekjen e Cekës.

Vendi vazhdoi të përjetonte nivele të larta të krimit të dhunshëm. Shumë vrasje ndodhën si pasojë e veprimeve hakmarrëse individuale ose klanore, të lidhura me "gjakmarrjet" tradicionale ose me konfliktet kriminale mes bandave. Sipas Ministrisë së Brendshme, të paktën nëntë persona u vranë gjatë vitit në gjakmarrje sipas Kodit mesjetar të Lekë Dukagjinit (Kanunit), e cila praktikohej sidomos në pjesët veriore të vendit. Sipas Kanunit, vetëm personat madhorë meshkuj mund të synohen në gjakmarrje; megjithatë, shpeshherë, gratë dhe fëmijët janë vrarë ose plagosur në sulme. Sipas Komitetit Kombëtar të Pajtimit, rreth 738 familje u vetëngujuan menjëherë gjatë vitit, si pasojë e gjakmarrjes. Frika e hakmarrjes si pasojë e gjakmarrjes bëri që 50 familje të jetonin në mbrojtje, jashtë vendit, dhe parandaloi rreth 200 fëmijë-75 prej të cilëve konsideroheshin në rrezik serioz-nga shkolla. Mosmarrëveshjet mbi pronat dhe trafikimi i njerëzve përbënte shkakun kryesor për gjakmarrjet.

Gjatë vitit, policia nuk arriti të identifikonte vrasësin e Emin Spahijas në gusht të 2004-ës dhe pezulluan hetimin e çështjes. Spahija ishte kreu i Organizatës Jo-Qeveritare (OJQ) Lidhja e Misionarëve të Paqes, që punonte ekskluzivisht mbi çështje të gjakmarrjes.

Ndërkohë që parlamenti në maj miratoi një ligj i cili krijonte një këshill bashkërendues, i kryesuar nga Presidenti për të hartuar një strategji kombëtare kundër gjakmarrjes dhe bashkërenduar aktivitetet e agjencive qeveritare, qeveria nuk e kishte zbatuar ligjin deri në fund të vitit.

Gjykata e Krimeve të Rënda gjykoi çështje të gjakmarrjes. Ligji parashikon 20 vjet burgim deri në burgim të përjetshëm për vrasjet në gjakmarrje.

b. Zhdukja

Nuk pati raportime për zhdukje për motive politike

c. Tortura dhe Trajtime apo Ndëshkime të Tjera Mizore, Çnjerëzore apo Poshtëruese

Ligji ndalon veprime të tilla; megjithatë, hera herës policia rrahu dhe torturoi persona të dyshuar. Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH) dhe Grupi Shqiptar për të Drejtat e Njeriut (GSHDNJ) vazhduan të raportonin që forcat e policisë në mbarë vendin përdornin torturën dhe trajtimin çnjerëzor apo të tepruar. Sipas GSHDNJ, shumica e keqtrajtimit ndodhte në kohën e arrestimit apo të ndalimit fillestar. Romët dhe anëtarë të komunitetit egjyptian ishin veçanërisht të prekshëm nga abuzimi i policisë (shih Seksioni 5).

Sipas prokurorisë, të burgosurit e Burgut 302 i dërguan një letër anonime Ministrit të Drejtësisë në prill duke pretenduar se ata keqtrajtoheshin rregullisht në qelitë e tyre nga rojet e burgut. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve hetoi pretendimet dhe përcaktoi se policia e burgut kishte keqtrajtuar fizikisht dhe psikologjikisht 24 individë shumë herë. Drejtoria e Përgjithshme shkarkoi drejtorin e burgut dhe shefin e policisë së burgut; megjithatë, autoritetet nuk kishin ngritur padi penale kundër oficerëve deri në fund të vitit.

Në shkurt, Edison Steno, një oficer i policisë gjyqësore në komisariatin e policisë, ndaloi dhe keqtrajtoi fizikisht dhe psikologjikisht 25 vjeçarin Mitrush Cipi nga Korca. Policia e mohoi kryerjen e keqtrajtimit, pavarësisht dëshmive të kundërta okulare.

Gjatë vitit, pati raportime se policia në pjesë të ndryshme të vendit rrahu dhe keqtrajtoi personat në kohën e arrestimit ose në kohën e paraburgimit.

Për shembull, policia rrahu shtatë studentë konviktorë në prill në komisariatin e policisë së Beratit, pas paraburgimit të tyre për sjellje të çrregullt. GSHDNJ-ja mblodhi prova mbi rastin në fjalë, dhe drejtori i shkollës pranoi se studentët ishin rrahur dhe deklaroi se policia, në mënyrë jo zyrtare, kërkoi ndjesë për sjelljen e saj. Deri në fund të vitit, autoritetet nuk kishin marrë masa disiplinore kundër oficerëve.

Në maj, Besnik Kosturi ngriti padi kundër një oficeri të policisë kriminale në Korçë, Oltion Agolli, për keqtrajtim. Oficeri e rrahu Kosturin pasi ai refuzoi të jepte informacione mbi një çështje që ishte pezull. Ekspertët mjekësorë verifikuan keqtrajtimin dhe oficeri u pezullua. Një hetim për çështjen në fjalë ishte pezull në fund të vitit.

Në qershor, Shpëtim Brahilka ngriti padi kundër një oficeri policie në Tiranë, Altin Bega, për keqtrajtim fizik. Hetimi i prokurorisë verifikoi se oficeri e kishte rrahur atë. Çështja ishte nën hetim në fund të vitit.

Në korrik, Arben Belaj ngriti padi kundër një anëtari të forcave speciale të policisë së Vlorës, Dritan Veizaj, pas pretendimeve të rrahjes së tij. Zyra e prokurorisë po hetonte rastin në fund të vitit.

Në korrik, Fredi Ndoci ngriti padi kundër Pjerin Lazri dhe oficerëve të tjerë të policisë së Shkodrës, për pretendime për rrahje në komisariatin e policisë. Një hetim paraprak konfirmoi se policia e ndaloi Ndocin, pasi kishte ngarë një makinë pa patentë dhe pa targa dhe kontrolli mjekësor verifikoi se Ndoci ishte rrahur dhe në pamundësi për të punuar për nëntë ditë. Prokurori vendor po hetonte rastin në fund të vitit.

Pavarësisht provave nga Avokati i Popullit dhe Prokuroria, një gjykatë pushoi ankesën e Majit 2004 nga Beqir Kaba se dy oficrë të komisariatit të policisë së Dibrës e kishin arrestuar në mënyrë të jashtëligjshme dhe keqtrajtuar atë. Dy oficerët u pezulluan përkohësisht, pas ndërhyrjes së zyrës së Avokatit të Popullit.

Nuk ka patur zhvillime përsa u përket rasteve të keqtrajtimeve të policisë të raportuara për vitin 2003 dhe 2004 që përfshijnë Stathi Lako, Behar Dedolli dhe Romeno Nexhipi.

Ndonjëherë, policia keqtrajtonte të rinjtë e ndaluar. Sipas Qendrës Shqiptare për të Drejtat e Fëmijëve (QSHDF), policia përdori kërcënime, dhunë dhe torturë për të nxjerrë informacione nga minorenët. Sipas GSHDNJ-ës, prokuroria në Korçë vazhdonte ta përdorte, dhe gjykata e pranoi, si p.sh. provat gjatë vitit që policia kishte nxjerrë nga tre minorenë nëpërmjet dhunës fizike në 2003 në një rast trafikimi kundër Gjergji Dabullës. Asnjë veprim nuk u mor kundër oficerëve të policisë të përfshirë.

Disa OJQ raportuan se policia synonte edhe komunitetin e homoseksualëve për keqtrajtim. (shih Seksionin 5).

Kishte raportime se policia rrahu protestuesit gjatë vitit (shih seksionin 2.b.).

Kushtet e burgjeve dhe të mjediseve të paraburgimit

Kushtet në burgje dhe mjediset e paraburgimit mbetën të këqija, dhe karakterizoheshin nga mungesa në ushqime dhe në ilaçe. Gjatë vitit, të burgosurit dhe të ndaluarit bënë revolta në Tiranë dhe Shkodër dhe hynë në greva urie dhe greva të tjera në burgjet e Krujës, Lushnjës, Tiranës, Peqinit, dhe Burrelit për të protestuar kundër kushteve të këqija të jetesës, transferimit të avashtë të të burgosurve nga ambjentet e paraburgimit në burgje dhe mangësive të tjera. Në shtator, një përplasje mes dy grupeve në burgun e Peqinit rezultoi në plagosjen e gjashtë të denuarve. Mbipopullimi ishte një problem serioz në qendrat e paraburgimit. Drejtori i burgjeve raportoi se duke filluar nga dhjetori, kishte 2,615 persona në burgje të cilat ishin ndërtuar për një kapacitet prej 2,668 dhe 870 persona (820 të ndaluar dhe 50 kriminelë të dënuar) në mjediset e paraburgimit të ndërtuara për një kapacitet prej 672 persona.

Në shtator, zyra e Avokatit të Popullit inspektoi ambjentit e paraburgimit të Komisariatit Katër në Tiranë dhe ambjentet e paraburgimit në qytete të tjera dhe përcaktoi se tetë shtetas kinezë (gjatë meshkuj dhe dy gra të ndaluar për mbajtje të dokumentave të jashtëligjshme) dhe të ndaluar të tjerë nuk ishin ushqyer. Avokati i Popullit i kërkoi Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive të Brendshme dhe të Drejtësisë të merrnin masa të menjëhershme për të ndihmuar të ndaluarit. Në fund të vitit, qeveria nuk kishte vepruar sipas kërkesës së Avokatit të Popullit.

Sipas Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, kishte 68 gra që vuanin dënimin në Burgun 325 për gra në Tiranë dhe 36 gra në ambjentet e paraburgimit. OJQ-të të cilat monitorojnë kushtet e burgjeve, vunë re se Burgu 325 kishte mangësi në ambjente për foshnjat e lindura nga të burgosurat, të cilat kishin mbetur shtatzanë gjatë kohës së burgimit.

Të paraburgosurit gjithmonë ndaheshin nga të burgosurit e dënuar, dhe të rinjtë e parandaluar nuk ndaheshin gjithmonë nga të rriturit. Njëzet nga tridhjetë e një të miturit të cilët vuanin dënimin në burgje në vend, mbaheshin në qendrat e paraburgimit, ku nuk nuk kishte mundësi për arsimimin e tyre dhe nuk ndaheshin gjithmonë nga të rriturit. Ndërkohë që burgu i Vaqarrit ka një pavion për të miturit, QSHDF-ja vuri re se të rinjtë qendronin bashkë me të rriturit në kohën e dusheve ose të aktiviteteve shplodhëse. Ndryshe nga vitet e kaluara, nuk ka raportime të keqtrajtimit seksual të të rinjve.

Qeveria lejoi vëzhguesit ndërkombëtarë të të drejtave të njeriut të vizitonin si qendrat e paraburgimit dhe burgjet; nuk kishte raportime mbi refuzimin për të lejuar hyrjen për inspektim nga monitoruesit e brendshëm, të pavarur të të drejtave të njeriut. Në maj dhe qershor, Komiteti Kundër Torturës i Këshillit të Evropës zhvilloi një vizitë të gjerë në burgjet dhe qendrat e paraburgimit të vendit; raporti i Komitetit mbi vizitën nuk është nxjerrë akoma dëri në fund të vitit. OSBE-ja gjithashtu ndërmori vizita në burgje gjatë vitit.

d. Arrestimi apo Ndalimi Arbitrar

Ligji e ndalon arrestimin apo ndalimin arbitrar; megjithatë, policia me raste arrestoi dhe ndaloi persona në mënyrë arbitrare.

Roli i Policisë dhe Aparatit të Sigurimit

Në shtator, Ministria e Rendit Publik kaloi në autoritetin e një Ministrie të Re të Brendshme. Njësitë vendore policore raportojnë tek Ministria e Brendshme dhe përbëjnë forcat kryesore të përgjegjshme për sigurinë e brendshme. Ushtria ka një njësi komando speciale prej 90 personash, e cila ka një rol kundër terrorizmit nën mbikqyrjen e Ministrit të Mbrojtjes. Ligji njeh mundësinë që Ministri i Brendshëm të kërkojë kontrollin e kësaj njësie gjatë një krize të brendshme. Shërbimi Informativ Shtetëror (SHISH) është i pergjegjshëm si për mbledhjen e informacioneve sekrete te brendshme dhe të jashtme si dhe për kundërzbulimin. Policia e Shtetit ka punësuar afërsisht rreth 12 mijë oficerë.

Aktiviteti i përgjithshëm mbi fuqizimin e ligjit ka mbetur i dobët. Sjellje joprofesionale dhe korrupsioni janë pengesat kryesore për zhvillimin e një force efektive, civile policore. Sipas Ministrisë së Brendshme, vetëm 40 për qind e oficerëve të policisë morën trajnime përtej gjërave themelore, pavarësisht asistencës nga qeveritë e huaja. Zyra e Kontrollit të Brendshëm të Policisë së Shtetit u përfshi në parandalimin, zbulimin dhe dokumentimin e aktivitetit kriminal të kryer nga policia. Gjatë nëntorit, Zyra kreu 172 hetime, të cilat rezultuan në arrestimin e 47 zyrtarëve të policisë dhe përjashtimin nga puna të 68 të tjerëve për sjellje të pahijshme.

Korrupsioni mbeti një problem mes forcave të policisë dhe pagat e ulëta dhe korrupsioni i përhapur gjerësisisht nëpër shoqëri e bënte problemin të vështirë për t'u luftuar. Zyra e Kontrollit të Brendshëm të Policisë së Shtetit raportoi të paktën 81 raste të korrupsionit për në prokurori gjatë nëntorit, të cilat përfshinin 118 oficerë police, 16 nga të cilët u arrestuan.

Nga janari në shtator, Prokuroria e Përgjithshme hetoi 20 raste që përfshinin 26 oficerë policie për kryerjen e veprimeve arbitrare ose shpërdorimin e detyrës. Zyra e përfundoi hetimin e saj në 11 raste, duke pushuar 9 çështje dhe pezulluar 2, për shkak të pamundësisë për të identifikuar kriminelin. Nëntë rastet e tjera ishin nën hetim në fund të vitit.

Padënueshmëria mbeti një problem, por gjithmonë e më pak. Avokati i Popullit mori 14 ankesa kundër oficerëve të policisë për përdorim të forcës ekstreme ose keqtrajtim deri në shtator. Avokati i Popullit përcaktoi se 2 ankesa ishin të velfshme dhe i konsideroi të tjerat pa themel. Nuk kishte asnjë informacion të mundshëm në fund të vitit nëse ishte marrë ndonjë veprim mbi ankesat e vlefshme.

Arrestimi dhe Ndalimi

Me ligj, një punonjës policie apo një prokuror mund të urdhërojë ndalimin e një të dyshuari. Personat e ndaluar duhet të informohen menjëherë për akuzat kundër tyre si dhe për të drejtat e tyre dhe një prokuror duhet njoftuar menjëherë pasi policia të ketë ndaluar një të dyshuar, dhe

një gjë e tillë përgjithësisht ka ndodhur në praktikë. Brenda 48 orësh pas arrestimit apo ndalimit, i dyshuari duhet të dalë përpara një gjykatësi. Gjykatësi ka 48 orë të tjera për të vendosur nëse i dyshuari mund të vazhdojë të mbetet i ndaluar. Në disa raste, persona të ndaluar janë mbajtur në ndalim paraburgimi më gjatë se 48 orë pa një vendim gjykate mbi faktin nëse prokurori ka apo jo fakte të mjaftueshme.

Gjykata mund të urdhërojë ndalimin në paraburgim në raste veçanërisht serioze që mund të paraqesin rrezik për shoqërinë. Përndryshe, i dyshuari mund të vendoset në arrest shtëpie. Mund të kërkohet lirim me kusht nëse gjykatësi beson që i akuzuari mund të mos paraqitet për gjyq.

Këshillim ligjor duhet të ofrohet pa pagesë nëse i pandehuri nuk mund të përballojë një avokat privat; megjithatë, kjo e drejtë nuk njihej gjerësisht dhe policia shpesh dështoi në informimin e të dyshuarve për këtë. Aksesi ndaj informacionit ligjor mbeti i vështirë për qytetarët. Pati raste të shumta në të cilat personat u ndaluan në mënyrë të jashtëligjshme dhe nuk ishin në gjendje të kontaktonin avokatët e tyre privatë. Në disa raste, të ndaluarit janë pyetur pa praninë e avokatëve të tyre mbrojtës. Shërbimet e ofruara nga shoqata shtetërore e avokatëve konsideroheshin të pamjaftueshme,korruptive dhe hera herës me mungesa profesionalizmi.

Gjatë vitit, Avokati i Popullit mori dy ankesa për arrestime arbitrare dhe ndalime të jashtëligjshme nga policia, por vendosi se asnjëra prej tyre nuk kishte bazë. Ndërkohë që nuk kishte raporte të tjera të arrestimeve dhe ndalimeve arbitrare nga policia, disa OJQ besojnë se këto përbënin akoma probleme.

Nuk pati raportime për të ndaluar për arsye politike.

Ligji kërkon përfundimin e hetimeve të paraburgimit brenda tre muajve. Por, një prokuror mund ta zgjasë këtë periudhë me periudha të tjera tre mujore për raste veçanërisht të vështira. Ndërsa ligji parashikon që kohëzgjatja maksimale e paraburgimit nuk duhet të kalojë dy vjet, paraburgimet të tejzgjatura përbënin një problem serioz si pasojë e hetimeve të vonuara. Në korrik, GSHDNJ-ja raportoi se Elton Gerdhuqi ishte mbajtur në komisariatin e policisë së Vlorës që nga vitit 2000 dhe se gjykata e Vlorës duhej akoma të nxirrte një vendim për rastin në fjalë. Dyzet e nëntë të burgosur u mbajtën në paraburgim edhe pas gjyqit të tyre.

e. Mohimi i Procesit Gjyqësor të Ndershëm Publik

Ligji siguron një gjyqësor të pavarur; megjithatë, presioni politik, kërcënimet, korrupsioni i shumëpërhapur, dhe burimet e kufizuara, e pengonin gjyqësorin të funksiononte në mënyrë të pavarur dhe të efektshme.

Tensioni vazhdoi midis policisë, prokurorisë, dhe gjyqësorit sidomos jashtë Tiranës. Secila palë përmendte dështimet e tjetrës si arsye pse kriminelët shmangnin burgosjen. Për shembull, gjykatat akuzonin prokurorët dhe policinë se dështonin të ofronin hetimin dhe faktet e qëndrueshme të nevojshme për ndjekje të suksesshme, dhe policia pretendonte se korrupsioni dhe rryshfetet kishin infektuar gjykatat. Policia Gjyqësore ishte përgjegjëse, nën drejtimin e prokurorëve, për zhvillimin e hetimeve të kryera fillimisht nga policia.

Sistemi gjyqësor përbëhet nga gjykatat e rretheve të shkallës së parë, gjashtë gjykata apeli, gjykatat e krimeve të rënda, gjykatat e apelit për krimet e rënda, gjykatat ushtarake të shkallës së parë, gjykatat ushtarake të apelit dhe një gjykatë kushtetuese e ndarë dhe e pavarur. Gjykata e Lartë merr në shqyrtim apelimet si nga gjykatat e rrethit ashtu edhe nga gjykatat e apelit, ndërsa Gjykata Kushtetuese në radhë të parë shqyrton ato çështje që kërkojnë interpretim kushtetues dhe konfliktet midis degëve të qeverisjes, si edhe çështje të individëve që pretendojnë mohimin e proceseve të rregullta gjyqësore. Gjykata e Krimeve të Rënda dhe Gjykata e Apelit e Krimeve të Rënda u përqendruan në luftën kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda dhe në përmirësimin e cilësisë së gjykimit.

Presidenti kryeson Këshillin e Lartë të Drejtësisë, i cili ka autoritetin të emërojë, marrë masa disiplinore dhe shkarkojë gjykatës të gjykatave të shkallës së parë dhe gjykatave të apelit. Gjykatësit që shkarkohen kanë të drejtën të apelojnë në Gjykatën e Lartë. Këshilli përbëhet nga Ministri i Drejtësisë, kryetari i Gjykatës së Lartë, nëntë gjykatës të të gjitha niveleve zgjedhur nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare dhe tre anëtarë të përzgjedhur nga Parlamenti.

### Procedurat gjyqësore

Ligji siguron të drejtën për një proces të shpejtë gjyqësor. Megjithatë, burimet e kufizuara materiale, mungesa e hapësirës, dhe numri i madh i çështjeve, në shumë raste, parandaluan sistemin gjyqësor nga gjykimi i çështjeve brenda afateve kohore. Regjistrat e gjatë të çështjeve ishin tipikë dhe rezultuan në atë që të dyshuarit të mbaheshin për afate më të gjata kohore se sa ato ligjore (shih seksionin 1.d.). I akuzuari, dëshmitarët dhe personat e tjerë të cilët nuk flasin shqip kanë të drejtë për shërbimet e një përkthyesi. Të akuzuarit kanë të drejtën të kenë një avokat dhe, sipas ligjit, Qeveria siguron avokatë për të pandehur të varfër, megjithëse cilësia e përfaqësimit ndryshon. I akuzuari ka të drejtën ta apelojë vendimin brenda 10 ditëve në Gjykatën e Apelit. I akuzuari prezumohet i pafajshëm deri në shpalljen e fajësisë.

Gjatë vitit, një numër procesesh, përfshi disa prej proceseve më të rëndësishme të vendit, u zhvilluan në mungesë, për shembull: gjyqi kundër Altin Arapit, vrasësit të dyshuar të shoferit të Prokurorit të Përgjithshëm; gjyqi kundër 13 anëtarëve, 7 prej tyre në mungesë, të një grupi të organizuar trafikimi që çoi në vdekjen e 29 personave në janar 2004; si dhe gjyqi i “Gaxhait” kundër 5 anëtarëve të një bande, 4 prej të cilëve po gjykoheshin në mungesë. Gjatë vitit, ka patur 98 gjykime në mungesë të cilët përfshijnë 171 të akuzuar.

Sistemi gjyqësor nuk zhvillohet përmes gjyqeve me juri. Prokurori dhe avokati mbrojtës kanë të drejtën të paraqesin raste përpara një paneli prej tre gjykatësish, dhe të pandehurit kanë të drejtën të njihen me të gjitha faktet që do të shqyrtohen nga gjykatësit.

Zyra e Përmbarimit siguron që gjykimet civile të zbatohen. Pavarësisht disa përmirësimeve, aktiviteti i zyrës ishte i dobët dhe shumë gjykime civile nuk u zbatuan.

Vendi nuk ka një sistem drejtësie për të rinjtë dhe çështjet e fëmijëve paraqiteshin vazhdimisht përpara gjykatësve të cilët nuk ishin trajnuar në drejtësinë për të rinjtë. Sipas Qendrës Shqiptare

për të Drejtat e Fëmijëve, dënime të gjata të dhëna për të rinjtë, ishin si pasojë e mungesës së trajnimeve të tilla.

Të ndara nga gjykata civile, gjykatat ushtarake janë në varësi të gjykatës së rrethit. Ata punësojnë gjyqtarë dhe prokurorë nga gjykatat civile për raste ushtarake, por ato nuk gjykojnë persona civilë.

Të burgosur politikë

Nuk pati raportime për të burgosur politikë.

Kthimi i pronës

Në korrik 2004, Parlamenti miratoi një ligj për kthimin dhe kompensimin e pronave të konfiskuara gjatë regjimit komunist. Disa ish-pronarë, përfshi edhe bashkësitë fetare, vunë në pikëpyetje kufizimin e ligjit për kthimin e pronës me një total prej 60 hektarësh. Ndërsa Qeveria përcaktoi një fond prej $2 milion (200 milion lek) për tu dhënë kompensim pronarëve, Komiteti Shtetëror dhe 12 komisionet vendore të përgjegjshme për zbatimin e ligjit nuk kishin fonde të mjaftueshme. Avokati i Popullit mori 55 ankesa në lidhje me kompensimin e pronës gjatë vitit; nuk kishte raporte se ishte zgjidhur ndonjë ankesë nga fundi i vitit. Megjithatë, në dhjetor, 28 persona u kompensuan deri në $100,000 (10 milion lek) secili për pronat e konfiskuara gjatë regjimit komunist.

f. Ndërhyrja Arbitrare në Jetën Private, Familje, Banesë, apo Korrespondencë

Ligji i ndalon veprime të tilla; megjithatë, me raste, Qeveria i shkeli këto të drejta.

Në janar, 18 familje Rome u detyruan të braktisnin shtëpitë e tyre, pasi ato bllokuan planin e rregullimit të territorit të një bashkie. (shih seksionin 5).

Seksioni 2 Respektimi i Lirive Civile, përfshirë:

a. Liria e Fjalës dhe e Shtypit

Ligji siguron lirinë e shprehjes dhe të shtypit dhe Qeveria përgjithësisht i respektoi këto të drejta në praktikë. Ndërsa media ishte aktive dhe përgjithësisht e pakufizuar, pati probleme serioze, themelore, me përdorimin e medias për qëllime politike.

Gjatë këtij viti zgjedhjesh, politizimi i medias u rrit në krahasim me vitet e kaluara. Botuesit dhe pronarët e gazetave, vazhduan të diktonin lajme për t'u shërbyer interesave të veta politike dhe ekonomike dhe hera herës të bllokonin ato që u kundërviheshin atyre interesave. Gazetarët vazhduan të praktikonin vetë-censurën dhe pati pak transparencë në financimin e organeve të medias. Katër OJQ vendore (Koalicioni Shqiptar Kundër Korrupsionit, Instituti i Sondazheve dhe Opinioneve, Institute për Kërkime Zhvillimi dhe Alternativa dhe Qendra për Transparencë dhe Informacion të Lirë) monitoruan median gjerë, përpara, gjatë dhe pas zgjedhjeve të përgjithshme. Ata arritën në përfundimin se shumica e medias së shtypur dhe asaj vizive

paraqitën një preferencë politike, por shkalla e preferencës u duk që pësoi rënie pas botimit të rezultateve monitoruese.

Individët mund të kritikonin lirshëm qeverinë dhe veprimet e saj në shtyp dhe në median vizive. Nuk ka patur raportime se zyrtarët përdorën ose kërcënuan të përdornin padi shpifjeje për të kufizuar diskutimin e lirë politik.

Në 2004, ish-Ministri i Rinisë, Kulturës dhe Sporteve Arta Dade dhe Ministri i Pushtetit Vendor Ben Blushi ngritën padi kundër Kryetarit të Partisë Demokratike Sali Berisha për shpifje pasi kishte akuzuar gojarisht Daden për korrupsion. Gjatë vitit, çështja u zgjidh jashtë procesit gjyqësor.

Media e pavaruar e shkruar ishte aktive, por e kufizuar për shkak të profesionalizmit të kufizuar, mungesës së financimeve dhe presionit politik. Partitë politike, sindikatat dhe grupe e shoqëri të ndryshme botuan gazetat ose revistat e tyre, në mënyrë të pavarur nga ndikimi qeveritar. Afërsisht dyqind botime ishin në gjendje, duke përfshirë gazeta të përditshme dhe javore, revista, buletine dhe pamflete.

Sipas të dhënave zyrtare, kishte 66 stacione televizive private dhe 45 stacione radio private, por numri aktual ishte më i lartë. Ndërkohë që stacionet televizive transmetonin në mënyrë të pavarur nga ndikimi i drejtpërdrejtë qeveritar, shumë pronarë besonin se përmbajtja e transmetimeve të tyre mund të ndikonin veprimet qeveritare përkundrejt bizneseve të tjera të tyre.

Radio Televizioni publik Shqiptar (RTVSH) përfshin një kanal kombëtar televiziv dhe një kanal kombëtar radiofonik. RTSH ia kushtoi shumicën e kohës së saj qeverisë dhe partisë në pushtet. Sipas ligjit, qeveria siguron 50 për qind të buxhetit të stacionit.

Atashimi politik kishte një ndikim të kudogjendur në programimet televizive dhe shumica e kanaleve ishin të njëanshme në mbulimet e tyre politike.

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit (KKRT) – një organ dypartiak shtatë-anëtarësh zgjedhur nga Parlamenti, me një të emëruar nga Presidenti – rregullonte çështjet e transmetimit. Pronarët e medias besonin se këshilli nuk arriti të përmbushte detyrat e tij rregullatore si pasojë e mungesës së përvojës, legjislacionit të paplotë rregullues dhe burimeve të pakta.

Në mars, gjykata e rrethit të Tiranës anulloi pezullimin e licensës së TV Shijak të dhjetorit të 2004 të dhënë nga KKRT, për shkak të shkeljeve të së drejtës së autorit dhe mospagimit të gjobës, mbi argumentimin se Këshilli duhej të kishte marrë masa paraprake përpara pezullimit të licensës.

Në maj, Partia opozitare Demokratike, i ktheu akreditimin televizionit privat NEWS 24, pasi ia kishte hequr dhe mohimit të stacionit për të patur akses në selinë e partisë në korrik 2004 për raportim të pretenduar të njëanshëm.

Ka patur një sërë raportesh se policia dhe zyrtarë të tjerë keqtrajtuan fizikisht gazetarët.

Në mars, një korrespondent për kanalin Top Channel, Juliana Dhimitri, filmoi policinë në Korçë duke mbyllur një dyqan. Shefi i policisë, Adrian Shehu, u ankua dhe përdori fjalë fyese për ta ndaluar. Kur kameramani u largua nga dyqani dhe filloi filmimin, Shehu u afrua dhe u mundua të largonte kameran disa herë. Kryetari i bashkisë së Korçës mbrojti më pas veprimet e shefit të tij të policisë. Dhimitri nuk ngriti padi. Në qershor, Dhimitri po filmonte një debat ndërmjet kandidatëve të zonës për në parlament, kur një mosmarrëveshje e ashpër filloi mes një kandidati dhe mbështetësve të kryetarit të bashkisë së Korçës. Gjatë incidentit, kryetari i bashkisë e kapi Dhimitrin nga shpatullat, e shtyu atë drejt një tryeze, dhe i konfiskoi kameran për 30 minuta. Ajo ngriti padi kundër kryetarit të bashkisë. Megjithatë, prokurorët e rrethit arritën në përfundimin se kishte prova të pamjaftueshme për të mbështetur një akuzë kriminale dhe e mbylli çështjen.

Në gusht, Gjolek Malaj, një i afërm i një zyrtari të lartë të partisë socialiste, rrahu gazetarët Mero Baze dhe Astrit Patozi gjatë ri-zhvillimit të zgjedhjeve në qytetin jugor të Gjirokastrës. Policia e arrestoi Malajn. Ministria e Rendit Publik përjashtoi katër oficerë policie për mosndërhyrje në parandalimin e sulmit. Hetimi i çështjes kundër Malaj u transferua nga prokuroria e rrethit në prokurorinë e përgjithshme. Në tetor, gjykata e rrethit të Gjirokastrës e shpalli Malajn fajtor dhe e dënoi me katër muaj në burgim. Autoritetet e liruan Malajn në mes të nëntorit, duke marrë parasysh kohën që ai kishte kryer në paraburgim që nga gushti.

Në tetor, zyra redaktuese e gazetës me tirazh më të lartë ditor *Shekulli* u dëmtua, kur një eksploziv u hodh në ballkonin e saj. Ndërsa nuk u godit askush, pati dëmtime ndaj zyrës. Një hetim ishtë në vazhdimësi në fund të vitit.

Ndryshe nga 2004, nuk kishte raporte që policia kishte ndaluar ose konfiskuar materialet e gazetarëve të cilët filmonin zyrtarë të lartë publikë.

Ka patur kërcënime politike për median. Gazetarët vazhduan të ankohen mbi censurën e drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga botuesit apo kryeredaktorët e tyre si përgjigje e presioneve politike ose tregtare. Shumë gazetarë ankoheshin se mungesa e kontratave të punësimit pengonte vazhdimisht aftësinë e tyre për të raportuar në mënyrë objektive. Në ndryshim me vitet e mëparshme, nuk kishte raportime që qeveria kishte përdorur kërcënimin e kontrolleve të taksave kundër medias për tu hakmarrë për raportime që kritikonin politikat e qeverisë.

Shpifja është një krim i dënueshëm me burgim deri në dy vjet ose me një gjobë. Në tetor, qeveria nxori një urdhër nga Kryeministri që orientonte zyrtarët të frenoheshin nga përdorimi i shkrimeve civile ose kriminale kundër gazetarëve.

Në shtator, gjykata e rrethit të Fierit gjobiti një correspondent të gazetës së përditshme *Korrieri* një mijë dollarë (100 mijë lek) për shpifje. Korrespondenti raportoi në tetor 2004 se një inspektor i policisë së Fierit përdorte karburantin që i përkiste stacionit të policisë së qytetit për makinën e tij private. Korrespondenti e apeloi vendimin dhe më 21 dhjetor, gjykata e apelit të Vlorës e anulloi vendimin fillestar.

Në janar, gjykata e apelit të Tiranës e anulloi dënimin e shpifjes së një deputeti të parlamentit, Nikolle Lesi pasi kishte raportuar në gazetën e tij, *Koha Jone*, se ish-Kryeministri Nano në

mënyrë të padrejtë i akordoi vetes së tij dhe këshilltarëve të tij një rrogë shtesë prej pesë muajsh. Vendimi i gjykatës së rrethit kishte vendosur në favor të Nanos dhe kishte gjobitur Lesin me $20 mijë (2 milion lek) për artikullin e janarit të 2004-ës.

Gjatë vitit, gjykata e rrethit të Tiranës refuzoi një akuzë për shpifje të sjellë nga shtëpia botuese që zotëron revistën *Spekter* kundër gazetarit Fatos Lubonja; Lubonja shkruante më përpara për *Spekter*. Gjykata e Apelit e respektoi vendimin.

Qeveria nuk kufizoi aksesin ndaj internetit; megjithatë, aksesi në internet mbeti i kufizuar sidomos jashtë qendrave kryesore urbane.

Qeveria hera herës kufizoi lirinë akademike. Gjatë vitit, gjykata e rrethit e refuzoi akuzën e ngritur nga shefi i departamentit të gjeografisë së Universitetit të Tiranës, Profesor Dorka në lidhje me shkarkimin e tij në 2004, pasi kishte një "përqasje anti-kombëtare në punën e tij." Shkarkimi ndodhi për shkak të botimit të një atlasi që zgjeronte zonat gjeografike të pakicave në vend. Qeveria, menjëherë, ndaloi botimin e atlasit. Çështja ishte pezull në gjykatën e apelit në fund të vitit.

b. Liria e Grumbullimit Paqësor dhe Grupimeve

Liria e Grumbullimit

Ligji siguron lirinë e grumbullimit dhe qeveria përgjithësisht e respektoi këtë të drejtë në praktikë.

Ligji kërkon nga organizatorët e grumbullimeve në vendet publike që të njoftojnë policinë e shtetit 3 ditë përpara. Nuk ka patur raste ku policia i mohoi këto grumbullime në mënyrë arbitrare. Në prill, autoritetet pezulluan çështjen kundër Mjaft, një lëvizje qytetare rinore, në lidhje me protestat e mbajtura në 2004.

Pati raste ku policia rrallëherë keqtrajtoi protestues gjatë vitit.

Në mars, rreth pesëqind persona në fshatin jugor të Kakomes shkëmbyen fjalë të rënda dhe u shtynë nga policia gjatë protestave mbi vendimin e qeverisë për t'ia shitur tokën e tyre një kompanie franceze. Shtatë persona u arrestuan dhe një oficer policie u plagos.

Liria e Grupimeve

Ligji mbështet të drejtën e grupimeve dhe qeveria në përgjithësi e respektoi këtë të drejtë në praktikë. Megjithatë, ligji ndalon formimin e ndonjë partie politike a organizate që është jotransparente ose e fshehtë. Nuk pati raportime që një dispozitë e tillë të përdorej kundër ndonjë grupi gjatë vitit.

c. Liria e fesë

Kushtetuta siguron lirinë e fesë dhe Qeveria përgjithësisht e respektoi këtë të drejtë në praktikë.

Bashkësitë mbizotëruese fetare-myslimanët sunitë, myslimanët bektashinj, ortodoksët, dhe katolikët romanë- gëzojnë një shkallë më të madhe njohjeje zyrtare (p.sh., festat kombëtare) dhe status shoqëror.

Qeveria nuk kërkon regjistrim apo licensim të grupeve fetare.

Aleanca Ungjillore Shqiptare, një shoqatë e afërsisht 98 Kishave Protestante, vazhdoi të ankohej gjatë vitit se kishte hasur pengesa administrative në aksesin në media. Megjithatë, përfaqësues të Aleancës Ungjillore deklaruan se nuk ishte e qartë nëse aksesi i kufizuar ishte për shkak të përmasave të vogla të organizatës apo përkatësisë së saj fetare.

Në përgjigje të raportimeve në media duke pretenduar se Dëshmitarët e Jehovait kishin ndikuar në një numër të vetëvrasjeve te fëmijët, drejtori i përgjithshëm i policisë shpalli më 4 maj se të gjitha "sektet e dyshimta" do të hetohen; megjithatë, nuk u përkufizua asnjëherë se çfarë përbënte një sekt të dyshimtë dhe policia nuk kishte marrë asnjë veprim deri në fund të vitit. Qeveria gjithashtu shpalli një ndalim të shpërndarjes së literaturës fetarë në "vendet publike", edhe pse në praktike ky ndalim zbatohet vetëm për ndërtesat qeveritare.

Qeveria nuk arriti t'u kthente komuniteteve të ndryshme fetare të gjitha pronat dhe objektet fetare, të cilat u konfiskuan gjatë regjimit komunist. Në rastet kur ndërtesat fetare u kthyen, Qeveria shpesh nuk ktheu tokën që rrethonte ndërtesat, as nuk ofroi kompensim. Për më tepër, Qeveria gjithashtu nuk ishte në gjendje të kompensonte kishat në masën e duhur për dëmet e gjera që shumë prona fetare vuajtën në periudhën e komunizmit.

Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë kishte probleme në rimarrjen e pronave, si dhe vështirësi në marrjen e disa ikonave fetare nga Qeveria për restaurim dhe mbrojtje. Kisha raportoi disa raste të izoluara vandalizmi ndaj kishave dhe kryqeve.

## Abuzime dhe diskriminime shoqërore

Në fillim të vitit, media botoi një numër artikujsh duke akuzuar se komuniteti i Dëshmitarëve të Jehovahit kishte ndikuar në një numër vetëvrasjesh të fëmijët. Artikujt rezultuan në incidente ngacmimesh shoqërore dhe kërcënime dhune kundër anëtarëve të komunitetit. Komunitetet e tjera fetare raportuan probleme të ngjashme duke përfshirë kërcënime dhe mbulime negative nga media.

Në fund të vitit, hetimet në vrasjen e vitit 2003 të ish-sekretarit të përgjithshëm të komunitetit islamik Sali Tivari ishin duke vazhduar.

Mendohet se ka më pak se njëqind çifutë në vend. Nuk ka patur raporte të sinagogave ose të qendrave komunitare që ekzistojnë në vend ose të ndonjë akti me natyrë anti-Semitiste.

Për më tepër diskutime, shih *Raportin Ndërkombëtar mbi Lirinë Fetare.*

d. Liria e Lëvizjes Brenda Vendit, Udhëtimi Jashtë, Emigrimi dhe Riatdhesimi

Ligji i siguron këto të drejta, dhe Qeveria përgjithësisht i respektoi ato në praktikë.

Si rezultat i migracionit të konsiderueshëm brenda vendit, shumë qytetarë nuk kishin më regjistrim dhe status vendor, çka çoi në humbjen e aksesit ndaj shërbimeve bazë të tilla si arsimi dhe kujdesi shëndetësor, sidomos për Romët. Qeveria nuk bëri asnjë përparim drejt krijimit të një dokumenti identiteti zyrtar kombëtar të standardizuar gjatë vitit.

Ligji e ndalon eksodin e detyruar dhe qeveria nuk e përdori këtë.

Mbrojtja e refugjatëve

Ligji siguron dhënien e azilit apo statusit të refugjatit në përputhje me Konventën e vitit 1951 të OKB-së lidhur me Statusin e Refugjatëve dhe Protokollin e vitit 1967 dhe qeveria ka përcaktuar një sistem për dhënien e mbrojtjes për refugjatët. Në praktikë, Qeveria ofroi mbrojtje kundër mosakordimit të statusit, d.m.th. kthimit të një personi në një vend ku kishin frikë nga persekutimi. Gjatë vitit qeveria i dha status refugjati ose azili një familjeje. Kishte 15 raste pezull në fund të vitit. Ekziston një procedurë apelimi, por kjo nuk funksionoi gjatë vitit.

Qeveria gjithashtu siguroi mbrojtje të përkohshme për individët të cilët nuk kualifikoheshin si refugjatë ose azilkërkues sipas Konventës së vitit 1951 dhe protokollit të vitit 1967, për 36 individë gjatë vitit.

Qeveria bashkëpunoi me zyrën e Komisionerit të Lartë të OKB-së për Refugjatët (UNHCR) dhe organizata të tjera humanitare për të ndihmuar refugjatët dhe azilkërkuesit. UNHCR, nëpërmjet Qendrës Kombëtare Pritëse të Azilkërkuesve, ofroi shërbime shoqërore dhe ligjore, mbulim të kujdesit shëndetësor, siguracion, dhe mbështetje të kufizuar me trainime për bashkësinë e vogël të refugjatëve të vendit dhe bashkërendoi asistencën e mëtejshme nëpërmjet një rrjeti OJQ-sh.

Së bashku me organizatat ndërkombëtare, qeveria, nëpërmjet programit së Asistencës së Bashkimit Evropian për Rindërtim, Zhvillim dhe Stabilizim (CARDS) parakontrolluan emigrantët e jashtëligjshëm të ndaluar në të gjitha pikat kufitare. Sipas programit, një OJQ dhe një ekip qeveritar ndihmuan policinë kufitare në identifikimin e viktimave të mundshme të trafikimit, azilkërkuesit dhe emigrantëve ekonomikë.

Qeveria përjashtoi refugjatët që mbërritën nga vendet të cilat i konsideronte të sigurta nga tranziti ose nga vendet të cilat i konsideronte të sigurta nga origjina.

Seksion 3 Respektimi i të Drejtave Politike: E Drejta e Qytetarëve për të Ndryshuar Qeverinë e Tyre

Ligji u siguron qytetarëve të drejtën për të ndërruar qeverinë e tyre paqësisht dhe qytetarët e ushtruan këtë të drejtë në praktikë përmes zgjedhjeve periodike të mbajtura mbi bazën e votimit të përgjithshëm.

Zgjedhjet dhe përfaqësimi politik

Në korrik, u mbajtën zgjedhjet parlamentare në të gjithë vendin. Raporti paraprak i misionit të vëzhgimit të zgjedhjeve të Organizatës për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë (OSBE) arriti në përfundimin se, gjatë periudhës para-zgjedhore, votimi dhe numërimi i votive deri më 4 korrik, zgjedhjet përmbushën vetëm pjesërisht standardet ndërkombëtare. Rezultatet zyrtare të zgjedhjeve u vonuan për javë të tëra për shkak të procedurave të ndërlikuara të ankimit dhe apelimit dhe nevojës për të rizhvilluar zgjedhjet në disa zona. Vëzhguesit e zgjedhjeve të OSBE-së raportuan një sërë rastesh ku zyrtarët e zgjedhjeve penguan procesin dhe vendosën interesat e partive përpara detyrës së tyre për të numëruar dhe raportuar votat në një mënyrë të paanshme dhe të ndershme. Pati edhe votim familjar, i cili ishte veçanërisht i përhapur në zonat rurale.

Individë dhe parti mund të shpallin lirshëm kandidimin e tyre dhe të marrin pjesë në zgjedhje. Një parti politike duhet të aplikojë në Gjykatën e Rrethit të Tiranës për regjistrim dhe të deklarojë një qëllim apo synim që nuk është anti-kushtetues apo përndryshe në kundërshtim me ligjin, të përshkruajë strukturën e vet organizative, dhe të shpjegojë të gjitha fondet publike dhe private që merr. Gjykatat regjistruan partitë në mënyrë rutine;

Ka 10 gra në parlamentin prej 140 vendesh, duke përfshirë Kryetaren e Parlamentit dhe një grua në qeveri. Megjithatë, në përgjithësi, gratë janë përfaqësuar dobët në nivelet qendrore dhe vendore të qeverisjes, pavarësisht përkushtimeve të partive kryesore politike për të rritur përfaqësimin e grave.

Disa anëtarë të minoritetit grek shërbyen si në parlametin prej 140 vendësh ashtu edhe në pushtetin ekzekutiv në vende ministrore dhe nënministrore. Asnjë pakicë tjetër etnike nuk mendohet të përfaqësohet në parlament ose qeveri.

Korrupsioni dhe transparenca qeveritare

Korrupsioni mbeti një pengesë madhore ndaj reformave domethënëse në vend. Një sondazh i gushtit të vitit 2004 nga Management Systems International gjeti se 94 për qind e publikut të përgjithshëm dhe 90 për qind e drejtuesve të bizneseve besonin se korrupsioni tek zyrtarët publikë ishte i përhapur. Gjatë vitit, prokuroria u mor me 266 raste që përfshinin 158 zyrtarë qeveritarë, të akuzuar për shpërdorim të detyrës dhe lloje të tjera të korrupsionit. Në maj, kryetari i komisionit të kthimit të tokave të Durrësit u dënua me 20 vjet burg për shpërdorim të detyrës dhe korrupsion.

Autoritetet nuk morën veprime ligjore ose disiplinore mbi bazën e deklaratave financiare të dorëzuara gjatë vitit. Megjithatë, 19 zyrtarë u gjobitën në maj për dorëzim të vonshëm. Kontrolle të 4,000 formave të deklarimeve financiare të zyrtarëve publikë nga Inspektoriati i Lartë për Deklaramin dhe Kontrollin e Pasurive në mars 2004, çoi në shkarkimin e pesë zyrtarëve dhe

referimin e dy të tjerëve në prokurori për hetim penal. Zyrtarët e shkarkuar përfshinin një zyrtar të lartë të ministrisë së transportit, i cili zotëronte kompaninë më të madhe të asfaltit në vend dhe një zyrtar të ministrisë së arsimit i përgjegjshëm për licensimin e shkollave private, i cili zotëronte vetë një shkollë private.

Në maj, një ligj i ri mbi konfliktin e interesave, i hartuar për të ndihmuar në eliminimin e korrupsionit qeveritar, hyri në fuqi. Ligji përcakton se ministrat qeveritarë nuk mund të zotërojnë një kompani e cila është e lidhur drejtpërsëdrejti me përgjegjësitë e tyre zyrtare. Gjatë vitit, pozicioni i veçantë ministror, i krijuar në 2004 për të luftuar korrupsionin u transferua tek Ministria e Brendshme.

Shtetas dhe jo shtetas, duke përfshirë edhe median e huaj, kanë të drejtë të marrin informacion rreth aktiviteteve të organeve të qeverisë dhe të personave të cilët ushtrojnë funksione zyrtare shtetërore. Zyrtarët publikë janë të detyruar në mënyrë ligjore të japin të gjithë informacionin dhe dokumentat zyrtarë, me përjashtim të dokumentave të klasifikuara dhe sekreteve shtetërore. Por, ky ligj nuk është zbatuar plotësisht, dhe aksesi i kufizuar për informacionin publik për shtetasit dhe joshtetasit, përbënte një problem. Një mungesë e zyrave informuese të qeverisë dhe një kuptim i kufizuar i ligjit nga zyrtarët qeveritarë, përkeqësuan problemin. Një studim i Qendrës për Studime Parlamentare dhe Fondacionit Soros gjeti se vetëm Presidenca botonte vendimet dhe dokumentat zyrtare në internet. Një OJQ vendase ngriti padi kundër Ministrisë së Arsimit, pasi ajo i mohoi të drejtën për akses ndaj informacionit të kërkuar. Gjyqi vazhdonte në fund të vitit.

Seksioni 4 Qëndrimi Qeveritar në Lidhje me Hetimin Ndërkombëtar dhe Joqeveritar të Shkeljeve të Pretenduara të të Drejtave të Njeriut

Një numër grupesh të të drejtave të njeriut, vendase dhe ndërkombëtare, kryenin aktivitetin e tyre përgjithësisht pa kufizim nga qeveria, duke hetuar dhe botuar përfundimet e tyre mbi çështjet e të drejtave të njeriut. Zyrtarë të Qeverisë ishin gjithnjë e më bashkëpunues dhe reagues ndaj pikëpamjeve të tyre. Megjithatë, në disa fusha – si dhuna kundër grave, përfshi dhunën në familje, dhe çështjet e fëmijëve – u bë pak përparim.

Organizata të pavarura të të drejtave të njeriut përfshijnë Komitetin Shqiptar të Helsinkit (probleme në lidhje me pakicat, forcat e sigurisë, gjyqësorin dhe zgjedhjet), Grupin Shqiptar të të Drejtave të Njeriut (asistencë ligjore e trajnim për policinë), Qendra Shqiptare për të Drejtat e Fëmijëve (të drejtat e fëmijëve) dhe Zyra për Mbrojtjen e Qytetarëve (korrupsionin zyrtar).

Qeveria bashkëpunoi me organizata ndërkombëtare, të tilla si UNHCR e Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM) dhe nuk kufizoi aksesin e tyre në vend.

Avokati i Popullit hetoi veprime të papërshtatshme, të pamjaftueshme apo të jashtëligjshme nga ana e Qeverisë. Megjithëse i mungonte pushteti për të vënë në zbatim vendime, Avokati i Popullit veproi si një roje ndaj shkeljeve të të drejtave të njeriut. Rastet më të shpeshta përfshijnë ankesa të qytetarëve për shpërdorim detyre nga policia e ushtria, mungesë të zbatimit të gjykimeve nga gjykatat në çështjet civile, shkarkime të gabuara dhe mosmarrëveshje për tokën (shih Seksionet 1.c. dhe 1.e.). Në shumë raste, Qeveria ndërmori veprime konkrete për të

korrigjuar probleme në përgjigje të përfundimeve të Avokatit të Popullit. Megjithatë, mosmarrëveshjet midis Avokatit të Popullit dhe Prokurorisë së Përgjithshme penguan bashkëpunimin.

Në muajin maj parlamenti nxori një ligj që fuqizonte autoritetin e Avokatit të Popullit që i jepte Avokatit të Popullit më shumë autoritet gjygjësor, e lejonte të hetonte e monitoronte ambjentet e paraburgimit e burgjet, si dhe të lehtësonte bashkëpunimin nga punonjësit e shtetit. Ligji i siguron Avokatit të Popullit autoritetin të hapë çështje kur viktimat nuk denoncojnë aktet apo në raste që përfshijnë interesin e bashkësisë.

Në maj e qershor, Komiteti i Këshillit të Europës kundër Torturës vizitoi vendin për të kontrolluar trajtimin e personave të arrestuar nga agjencitë e zbatimit të ligjit, kushtet në ambjentet e paraburgimit e burgjet, si dhe kompensime ligjore në rastet që përfshijnë deklarata keqtrajtimesh policore. Komiteti nuk kishte nxjerrë raportin e tij mbi vizitën deri në fund të vitit.

Seksioni 5 Diskriminimi, Abuzime Shoqërore e Trafikimi i Personave

Ligji e ndalon diskriminimin bazuar mbi seksin, racën, etninë, paaftësinë, gjuhën apo statusin shoqëror; megjithatë, diskriminimi kundër grave dhe grupeve të pakicës rome vazhdon.

Gratë

Dhuna në familje kundër grave, përfshirë abuzimin bashkëshortor mbetën probleme serioze. Në shoqërinë e vendit që është tradicionalisht e dominuar nga meshkujt, normat shoqërore dhe përgjigja e dobët e policisë bënë që shumica e abuzimeve të mos raportohen. Kjo vështirësonte të përcaktohej numri i grave viktima të përdhunimit, dhunës në familje si dhe ngacmimet seksuale. Sipas projektit të monitorimit të mediave 2002-2003 të Qendrës për Nisma Civile Ligjore, 56 gra e vajza në të gjithë vendin humbën jetën si rezultat i dhunës në familje dhe 74 të tjera ishin plagosur rëndë. Gjatë shtatorit qendra mori 180 ankesa për dhunë në familje. Qendra Gratë për Gratë, një OJQ që operon kryesisht në pjesën veriore të vendit, raportoi që merrte rreth 20 telefonata në ditë nga gra që raportonin një formë të dhunës.

Shumë bashkësi, sidomos ato të pjesës verilindore të vendit, vazhdojnë të ndjekin kodin tradicional – *kanunin* – në të cilin, sipas disa interpretimeve, gratë konsiderohen se janë dhe trajtohen si pronë. Sipas kanunit, disa interpretime diktojnë që detyra e gruas është që t'i shërbejë burrit të saj dhe të jetë inferiore ndaj tij në të gjitha çështjet.

Ligji nuk i drejtohet specifikisht dhunës kundër grave, megjithëse përmban dispozita që synojnë mbrojtjen e bashkëshortëve nga dhuna në familje. Në praktikë gjykatat nuk e kanë përdorur këtë mjet ligjor për shkak të mungesës së kuptimit mbi aplikimin e ligjit.

Pamundësia e mbrojtjes ligjore kundër dhunës në familje u ilustrua në rastin e vrasjes në shkurt 2004 e një vajze 21-vjeçare nga i ati i saj për vonesë dhe dënimi më pas i të atit me më pak se 2 vjet burgim. Vrasja mori shumë vëmendje nga media dhe nga bashkësia e OJQ-ve; megjithatë, çështja nuk u apelua.

Qeveria nuk kishte programe për të luftuar dhunën në familje apo tu vinte në ndihmë viktimave. Një OJQ mbante një qendër strehimi në Tiranë për gratë e abuzuara, megjithëse ambjentet kishin kapacitetin të strehonin vetëm pak viktima. E njëjta OJQ gjithashtu operonte një linjë telefonike të posaçme që siguronte këshilla e konsultim për gratë e vajzat.

Përdhunimi është i ndëshkueshëm me ligj, ashtu si dhe përdhunimi bashkëshortor; megjithatë, në praktikë përdhunimi bashkëshortor nuk raportohet apo ndiqet penalisht. Konceptet e përdhunimit bashkëshortor dhe ngacmimit seksual nuk ishin të përcaktuara mirë dhe, për pasojë, akte të tilla shpesh nuk u konsideruan krime nga autoritetet apo publiku.

Ligji e ndalon prostitucionin, por ai ishte problem. Trafikimi i grave për qëllime shfrytëzimi seksual mbeti problem (shih Seksioni 5, Trafikimi).

Ligji ndalon ngacmimin seksual; megjithatë shumë rrallë është përdorur në praktikë. Në muajin prill, një zyrtar i lartë qeveritar u shkarkua për ngacmim seksual.

Gratë nuk u përjashtuan, as me ligj as në praktikë, nga ndonjë vend pune; megjithatë, ato nuk ishin të përfaqësuara mirë në nivelet më të larta të fushave të tyre. Ligji detyron pagesë të barabartë për punë të barabartë; megjithatë, ndërkohë që gratë vazhduan të fitonin gradualisht pushtet ekonomik, kjo dispozitë nuk u zbatua plotësisht. Gratë gëzonin akses të barabartë ndaj arsimit të lartë, por nuk iu dhanë mundësi të plota dhe të barabarta në karrierat e tyre dhe gratë me arsim të mirë ishin shpesh të nënpunësuara apo punonin jashtë fushës së specializimit të tyre.

Ligji garanton të drejta të barabarta për burrat dhe grate nën ligjin e familjes, ligjin e pasurisë si dhe në sistemin gjygjësor. Në praktikë, traditat kulturore rezultonin që burrat shpesh ishin më të favorizuar nga gratë. Komiteti për Mundësi të Barabarta i Qeverisë ishte detyruar për të shkruar, nxitur dhe monitoruar programe të barazisë gjinore. Megjithatë, Komiteti ishte i keqfinancuar dhe i mungonte ndikimi politik. Komiteti Ndër-Ministror për Barazinë Gjinore, një trup këshillues i përcaktuar me ligj, nuk u mblodh asnjëherë gjatë vitit.

Fëmijët

Përkushtimi i Qeverisë ndaj të drejtave dhe mirëqenies së fëmijëve është i kodifikuar në ligjet e brendshme; megjithatë, në praktikë, pati përkushtim të kufizuar.

Ligji parashikon të drejtën për 9 vjet shkollim falas si dhe autorizon shkolla private. Ndjekja e shkollës ishte e detyrueshme deri në klasën e nëntë (ose deri në moshën 16-vjeçare, cilado vinte më shpejt); megjithatë, në praktikë, shumë fëmijë largoheshin nga shkolla më herët se sa lejohet nga ligji me qëllim që të punonin me familjet e tyre, sidomos në zonat fshatare (shih Seksioni 6.d.). Prindërit duhej të paguanin për pajisje, libra, materiale shkollore, si dhe ngrohës për disa klasa, e cila ishte e shtrenjtë deri në pamundësi për shumë familje. Mungesa e dokumentave të përshtatshme – shumë prej të cilave kishin humbur për shkak të migracionit të brendshëm – pengonte shumë nxënës të ndiqnin shkollën (shih Seksioni 2.d.). Sipas statistikave të Bankës Botërore, regjistrimi në shkollat e mesme për djem e vajza ishte vetëm 38.7 përqind, ndërsa Instituti Shqiptar i Statistikave vlerësoi përqindjen e rregjistrimit në 53. Sipas Fondit të OKB-së

për Fëmijët (UNICEF), përqindja e ndjekjes së shkollës fillore për të gjithë fëmijët në moshën nga 7 deri në 14 vjeç, ishte 90 përqind.

Në parim, kishte akses të barabartë ndaj kujdesit shëndetësor si për djemtë ashtu edhe për vajzat; megjithatë, niveli i lartë i rryshfet-dhënies në sistemin e kujdesit shëndetësor hera herës e kufizonte aksesin.

Pas një dhjetëvjeçari migracioni domethënës të brendshëm, pagesat e larta për regjistrim civil kanë penguar shumë qytetarë që të regjistrohen pranë autoriteteve në vendet e tyre faktike të banimit. Si rezultat, fëmijët e lindur nga këta individë nuk kanë certifikata lindjeje apo dokumentacion tjetër ligjor. Ligji kërkon që prindërit që nuk regjistrojnë fëmijët e tyre brenda 30 ditësh nga lindja e fëmijës, që të shkojnë në gjykatë, ku ka gjasa të vendosen gjoba për mosregjistrim të duhur qysh në fillim. Kështu, vendi ka një popullsi të madhe – dhe në rritje – fëmijësh të pambrojtur, të paregjistruar, të cilët janë në rrezik trafikimi apo shfrytëzimi, veçanërisht nga bashkësia Rome.

Abuzimi i fëmijëve, përfshi abuzimin seksual, ishte i kudondodhur por raportohej rrallë. Sipas Ministrisë së Brendshme, 20 raste krimesh seksuale kundër fëmijëve, ishin raportuar gjatë vitit.

Sipas statistikave mbi vitin nxjerrë nga Komiteti Kombëtar i Pajtimit, deri 200 fëmijë mbeteshin të rrezikuar nga gjakmarrje që preknin familjet e tyre; 75 prej këtyre fëmijëve konsideroheshin se jetonin në rrethana veçanërisht të rrezikshme (shih Seksioni 1.a.).

Martesa e fëmijëve ishte një problem. Meqë nuk kishte statistika të disponueshme, martesa e fëmijëve ishte me sa duket më e përhapur në popullsinë Rome si dhe akoma kishte disa bashkësi në veri dhe në verilindje të vendit ku ekziston mblesëria tradicionale “martesa në djep” bazuar në marrëveshjet prindërore.

Trafikimi i fëmijëve, edhe pse jo i shumëpërhapur, ishte problematik (shih Seksioni 5, Trafikimi).

Puna e fëmijëve mbetej një problem madhor (shih seksionin 6.d.).

Fëmijët e pastrehë, të zhvendosur apo të rrugëve mbetën problem, sidomos fëmijët romë. Fëmijët romë jetonin në varfëri ekstreme anembanë vendit. Ata lypnin në rrugë apo bënin punë të tjera të vogla dhe shumë imigronin në vendet fqinje, sidomos gjatë verës.

Trafikimi i Personave

Ligji e ndalon trafikimin e personave dhe përcakton ndëshkime për trafikantët; megjithatë, persona, veçanërisht gra dhe fëmijë, u trafikuan për në vend, nga vendi, dhe brenda vendit. Korrupsioni i policisë dhe përfshirja e policisë në trafikim ishin gjithashtu probleme.

Ligji përcakton ndëshkime nga 5 deri në 15 vjet burg për trafikimin e persnoave; 7 deri 15 vjet burg për trafikimin e femrave për prostitucion; dhe 15 deri 20 vjet burg për trafikim të minorenëve. Rrethana rënduese, të tilla si rrëmbimi apo vdekja e një personi, mund ta rrisin

ashpërsinë e ndëshkimit deri në maksimumin e burgimit të përjetshëm. Ndëshkimeve me burg mund t'u shtohen gjoba prej 4,000 deri 6,000 dollarë (400,000 deri 600,000 lekë) për shfrytëzim seksual të një minoreni dhe 3,000 deri 6,000 dollarë (300,000 deri 600,000 lekë) për shfrytëzim seksual të femrave. Ligji siguron që një zyrtar qeveritar i dënuar për shfrytëzim për prostitucion të marrë 125 përqind të dënimit standart. Ligji gjithashtu mandaton sekuestrimin dhe konfiskimin e aseteve që burojnë nga krimi i organizuar dhe trafikimi. Në qershor, Këshilli i Ministrave ngriti një agjenci qeveritare për të administruar asetet e sekuestruara dhe të konfiskuara.

Në shkurt, qeveria miratoi një strategji mbi trafikimin e fëmijëve dhe një plan veprimi kombëtar për periudhën 2005-2007 bazuar mbi udhëzimet e UNICEF dhe mbi parimin e kthimit vullnetar të ndihmuar të viktimave fëmijë. Megjithatë, deri në fund të vitit, qeveria nuk kishte ngritur një strukturë institucionale për ta vënë në zbatim strategjinë dhe planin e veprimit.

Ndjekja penale e trafikantëve mbeti një problem. Autoritetet shpesh liruan trafikantë të arrestuar për shkak të provave të pamjaftueshme ose, nëse ishin ndjekur penalisht, i akuzuan për krime më të lehta apo u dhanë dënime më të ulëta se sa dënimi minimal për trafikim. Sipas prokurorisë, deri në fund të vitit pati 341 çështje të trafikimit të personave në vazhdim që përfshinin 343 të paditur. Deri në nëntor ishin dënuar 179 individë dhe, në katër prej çështjeve, gjykatat dënuan 10 të pandehur për trafikim personash dhe dënuan secilin me të paktën dënimin minimal. Policia ndaloi 53 individë në lidhje me trafikimin e grave për shfrytëzim seksual.

Në nëntor 2004, gjashtëmbëdhjetë individë u dënuan me burg për 1 deri 10 vjet secili për dhunë seksuale kundër një vajze 16-vjeçare në bazën detare Bishti i Pallës. Në vitin 2003, vajza ishte futur fshehurazi në bazë për të kryer marrëdhënie seksuale me marinarë dhe u mbajt në një ndërtesë gjysmë të braktisur për dy muaj, ku u përdhunua në mënyrë të përsëritur përpara se të trafikohej në Kosovë.

Çështja e vitit 2003 kundër drejtuesve të një rrjeti trafikimi fëmijësh në Durrës, që përfshinte një zyrtar të doganës së porti dhe kreun e zyrës lokale të SHISh, nuk shkoi në gjykatë. Megjithatë, katër individë të tjerë të lidhur me çështjen u dënuan me burg për 3 deri 6 vjet secili.

Vendi nuk mori pjesë në ndonjë operacion rajonal anti-trafikim gjatë vitit; megjithatë, autoritetet ekstraduan 35 perona për trafikim dhe kundravajtje të tjera. Në gusht 2004, autoritetet morën pjesë në një goditje rajonale anti-trafik organizuar nëpërmjet Qendrës së Nismës së Bashkëpunimit të Europës Juglindore rezultoi në 125 arrestime në mbarë rajonin për forma të ndryshme të trafikimit, prostitucionit dhe kontrabandës.

Në vitin 2003, Gjykata e Krimeve të Rënda mbështeti dënimin e shtatë personave me 10 deri 20 vjet burg për trafikimin e foshnjeve të sapolindura në Greqi.

Gjatë vitit, qeveria filloi zbatimin e ligjit për mbrojtjen e dëshmitarëve të prillit 2004, duke ngritur një njësi për mbrojtjen e dëshimitarëve në drejtorinë e krimit të organizuar dhe mbrojtjes së dëshmitarëve në Policinë e Shtetit, dhe duke emëruar një komision për të vlerësuar aplikimet për pranim në programin e mbrojtjes së dëshmitarëve. Në qershor, qeveria miratoi rregulloren e parë për zbatimin e ligjit. Deri në fund të vitit, në program ishin pranuar tre individë, megjithëse

asnjë nuk ishte transferuar. Pavarësisht këtyre përpjekjeve, mbrojtja e dëshmitarëve mbeti një problem serioz dhe frika nga ndëshkimi tek dëshmitarët mbeti një shkurajim i fortë për ndjekjen e efektshme penale të çështjeve të krimit të organizuar dhe trafikimit.

Vendi mbeti një bend burim për trafikimin e grave dhe fëmijëve për qëllime shfrytëzimi seksual dhe pune të detyruar, por u vlerësua nga vëzhgues ndërkombëtarë se nuk ishte më një vend kryesor për tranzitimin. Gratë dhe vajzat e huaja relativisht të pakta që ishin tranzit vinin kryesisht nga Serbia dhe Mali i Zi (Kosovë), dhe, më pak nga Moldavia, Rumania, Ukraina, Rusia, Bullgaria, Sri Lanka dhe Kina. Shumica e grave dhe vajzave të trafikuara u transportuan në Itali, Greqi dhe vende të tjera europiane, të tilla si Belgjika, Franca, Mbretëria e Bashkuar, Hollanda dhe Norvegjia. Pati një rritje domethënëse në trafikimin e fëmijëve për në Kosovë për të lypur apo për shfrytëzim seksual. Trafikantët kryesisht përdornin linja rrugore nga Greqia (nëpërmjet Maqedonisë) apo Mali i Zi ose dokumenta të falsifikuara për të transportuar viktimat e tyre me avion apo traget.

Sipas OJQve, afërsisht 1,000 fëmijë shqiptarë të pashoqëruar jetonin në Itali, megjithëse jo të gjithë ishin viktima të trafikimit. Një studim i vitit 2002 kryer nga OJQ Shërbimi Social Ndërkombëtar raportonte se 1,800 fëmijë shqiptarë të pashoqëruar – shumë prej të cilëve ishin viktima të trafikimit – jetonin në Greqi. Sipas Terre des Hommes (TdH), një OJQ zvicerane që merret me mirëqenien e fëmijëve aktive në Shqipëri, numri i fëmijëve të trafikuar për në Greqi ka rënë gjatë viteve të fundit.

Trafikimi i brendshëm u rrit gjatë vitit. TdH identifikoi dhe ndihmoi 126 fëmijë të trafikuar, afërsisht 53 prej të cilëve ishin të trafikuar brenda vendit. Fëmijët përgjithësisht trafikoheshin për të lypur me forcë apo për shfrytëzim seksual. Bashkësitë rome dhe egjiptiane ishin sidomos të prekshme për shkak të varfërisë dhe analfabetizmit. Në pak raste, fëmijët bliheshin nga familjet ose rrëmbeheshin, sipas raporteve, për të lypur apo punuar jashtë vendit. Sipas TdH, fëmijët, kryesisht nga bashkësitë rome dhe egjiptiane, u trafikuan gjithmonë e më shumë për të lypur nga prindërit e tyre pa përfshirjen e një pale të tretë.

Format kryesore të rekrutimit përfshinin martesën me mashtrime apo me premtime të rreme për martesë për të joshur viktimat të shkonin jashtë vendit për shfrytëzim seksual. Për shkak të situatës së varfër ekonomike, burra dhe gra nga grupe të organizuara kriminale gjithashtu joshnin shumë gra dhe vajza nga i gjithë vendi duke iu premtuar vende pune në Itali dhe Greqi. Në mënyrë tipike, trafikantët konfiskonin dokumentet e viktimave dhe shpesh i detyronin të punonin si prostituta përpara se të largoheshin nga vendi. Si shtetasit ashtu edhe femrat e huaja të trafikuara nga rrjete vendase të krimit të organizuar abuzoheshin, troturoheshin dhe përdhunoheshin. Trafikantët gjithashtu kërcënonin shumë prej anëtarëve të familjeve të viktimave. Në një masë më të ulët, anëtarët e familjeve të fqinjëve shisnin viktima – sidomos fëmijë romë – tek trafikantët ose trafikantët rrëmbenin fëmijë, përfshi edhe nga jetimoret.

Policia shpesh ishte e përfshirë drejtpërdrejt ose tërthorazi në trafikim. Gjatë vitit, autoritetet arrestuan një oficer policie për trafikim, i cili u gjykua, por nuk u dënua; autoritetet nuk ndoqën penalisht ndonjë tjetër zyrtar qeveritar për kundravajtje të trafikimit. Trafikantët gjithashtu manipulonin avokatët dhe gjyqtarët dhe gjenin mënyrën për t'i shpëtuar ndëshkimit me anë të

rryshfetit. Gjatë vitit, zyra e kontrollit të brendshëm e Ministrisë së Brendshme hetoi vetëm pesë çështje të përfshirjes së policisë në të gjitha format e trafikimit.

Qeveria ofroi shërbime shumë të kufizuara për viktimat e trafikimit. Për shembull, qeveria administronte një qendër në Tiranë, por vetëm me asistencë nga OJQ. Një numër OJQsh ishin aktive në trajtimin e nevojave të viktimave. IOM administronte një qendër riintegrimi në Tiranë që ofronte shërbime këshillimi dhe mjekësore, trainim për punë dhe njëfarë asistence ligjore. Streha Vatra, një OJQ në Vlorë, ofronte shërbime të ngjashme. Të dyja qendrat raportuan se një përqindje e lartë e çështjeve të tyre gjatë vitit kishin të bënin me viktima të deportuara nga vende të tjera europiane.

Trajtimi i grave të trafikuara nga policia vazhdoi të përmirësohej gjatë vitit; megjithatë, femrat e huaja të ndaluara nga policia, hera herës nuk kishin shërbime përkthimi dhe ose nuk u jepej mundësia për të zgjedhur avokatin.

Viktimat e trafikimit shpesh u përballën me stigmatizim të madh prej familjeve të tyre dhe shoqërisë. Sipas Strehës Vatra, ka pasur shumë raste ku familjet i kanë kërcënuar viktimat e trafikimit, përfshi minorenët, me vdekje për shkak të së kaluarës së tyre. Ritrafikimi ishte një problem madhor, ku 131 nga 228 viktima të strehuara në Strehën Vatra gjatë vitit raportuan se kishin qenë trafikuar të paktën dy here të tjera më parë dhe 7 prej viktimave ishin nën kërcënime të vazhdueshme nga keqbërësit. Nga 228 viktimat në qendër, 28 kishin qenë trafikuar brenda vendit dhe pjesa tjetër ishin nga vende të tjera.

Qendra anti-trafikim e Vlorës, e cila u hap në vitin 2001, nuk ishte plotësisht në funksionim por u përdor për trainim rajonal. OJQ vendase dhe ndërkombëtare kryen pjesën më të madhe të programeve të vendit për ndërgjegjësim mbi trafikimin.

Personat me Paaftësi

Ligji ndalon diskriminimin kundër personave me paaftësi; megjithatë, pati njëfarë diskriminimi kundër personave me paaftësi në punësim, arsimim, akses ndaj kujdesit shëndetësor, dhe sigurimit të shërbimeve të tjera shtetërore. Varfëria e përhapur gjerësisht, kushtet e parregulluara të punës, si dhe kujdesi i ulët shëndetësor paraqisnin probleme domethënëse për shumë persona me paaftësi. Ndërkohë që ligji kërkon që ndërtesat e reja të sigurojnë akses për personat me paaftësi, qeveria nuk ndërmori sigurimin e një aksesi të tillë.

Pakicat Kombëtare/Racore/Etnike

Pati raportime për dhunë dhe diskriminim nga qeveria dhe diskriminim nga shoqëria kundër anëtarëve të grupeve të pakicave, sidomos bashkësive rome dhe egjiptiane.

Ligji lejon statusin zyrtar të pakicës për grupe kombëtare dhe grupe etnogjuhësore. Grekët janë pakica më e madhe, ndjekur nga grupe të vogla maqedonësish dhe malazezësh; arumunët (vllehët) dhe romët përkufizohen si grupe pakicash etnogjuhësore. Qeveria nuk i ka dhënë statusin e pakicës bashkësisë egjiptiane, duke i mohuar mbrojtjet kushtetuese kundër diskriminimit, të cilat i gëzojnë grupe të tjera. Për t'u kualifikuar për statusin e pakicës sipas

ligjit, një grup individësh duhet të ndajnë të njëjtën gjuhë (të ndryshme nga shqipja), të kenë dokumentacion që provon origjinën e vet të dallueshme etnike apo identitetin kombëtar, si dhe të kenë zakone e tradita të dallueshme, apo lidhje me një shtet të përafërt jashtë vendit. Qeveria pohonte se egjiptianët nuk përmbushnin disa kritere, të tilla si gjuhë dhe tradita të dallueshme, dhe i konsideronte ata një bashkësi.

Sipas Qendrës Europiane për të Drejtat Rome, në fillim të janarit, policia ndërtimore e bashkisë së Tiranës sipas raportimeve rrahu dhe vrau Dritan Hasimin, një rom 22-vjeçar, kur rezistoi ndaj shkatërrimit të shtëpisë së tij gjatë prishjes së një vendbanimi të jashtëligjshëm rom. Autopsia zyrtare arriti në përfundimin se Hasimi kishte vdekur nga helmimi prej alkoolit.

Gjatë vitit pati raporte që policia rrahu romë dhe egjiptianë.

Pati raportime që policia zhvendosi familje rome dhe egjiptiane nga strehimi i tyre i përkohshëm. Më 6 janar, bashkia e Tiranës shkatërroi shtëpitë e 18 familjeve rome prej 150 personash, sipas raporteve, pa paralajmërim, duke i lënë pa shtëpi në mes të dimrit. Bashkia shkatërroi shtëpitë, të vendosura në një zonë pranë lumit Lana, sepse bllokonin planin e saj për rregullimin e territorit dhe ishin të jashtëligjshme. Një çështje e ngjashme rezultoi në zhvendosjen e 51 familjeve rome në qershor 2004.

Bashkësitë rome dhe egjiptiane ishin ndër grupet më të neglizhuara politikisht, ekonomikisht, dhe shoqërisht në vend. Anëtarë të bashkësisë egjiptiane kishin prirjen të vendoseshin në zonat urbane dhe në përgjithësi ishin më të integruar në ekonomi në krahasim me romët. Përveç diskriminimit të përhapur shoqëror, këto grupe në përgjithësi vuanin nga analfabetizmi i lartë, sidomos mes fëmijëve, kushte të këqija shëndeti, mungesë arsimi dhe disavantazhe të theksuara ekonomike. Në fund të vitit, qeveria nuk e kishte vënë në zbatim strategjinë e saj kombëtare për përmirësimin e kushteve të jetesës së pakicës rome.

Pakica greke etnike ndoqi ankesat me qeverinë në lidhje me zonat zgjedhore, arsimin në gjuhën greke, të drejtat e pronës dhe dokumentat qeveritare. Udhëheqësit e pakicës u ankuan për mosgatishmërinë e Qeverisë për të njohur ekzistencën e mundshme të qyteteve etnike greke jashtë “zonave minoritare” të periudhës komuniste; për të përdorur greqishten në dokumente zyrtare dhe në tabelat publike në zonat etnike greke; për të përcaktuar përmasat e popullsisë greke etnike; dhe për të përfshirë një numër më të madh grekësh etnikë në administratën publike.

Ndërkohë që shkollat fillore publike në gjuhën greke ishin të zakonshme në pjesën jugore të vendit ku jetojnë shumica e grekëve etnikë, shoqata kulturore greke Omonia u ankua që bashkësia kishte nevojë për më shumë si brenda ashtu edhe jashtë zonave minoritare. Çdo fshat në zonat greke kishte shkollën e vet fillore-nëntë-vjeçare) në gjuhën greke, pavarësisht nga numri i nxënësve, dhe në Gjirokastër kishte dy shkolla të mesme në gjuhën greke.

### Abuzime dhe Diskriminime të Tjera Shoqërore

OJQtë pretenduan që policia pati vënë në shënjestër bashkësinë homoseksuale të vendit për abuzim. Sipas sekretarit të përgjithshëm të Gay Albania, policia shpesh, në mënyrë arbitrare, arrestoi homoseksualë dhe më pas abuzoi fizikisht dhe verbalisht me ta gjatë kohës së ndalimit.

Sipas zyrës së Avokatit të Popullit, në qershor, policia në komisariatin e policisë në Tiranë ndaloi, ofendoi dhe keqtrajtoi fizikisht një anëtar të shoqatës Gay Albania. Ekspertë të shëndetësisë e verifikuan keqtrajtimin dhe zyra e Avokatit të Popullit filloi një hetim. Kundër oficerëve të policisë nuk ishte ndërmarrë asnjë veprim deri në fund të vitit.

Seksioni 6 Të Drejtat e Punëtorëve

a. E Drejta e Shoqatës

Punëtorët kishin të drejtën të formonin sindikata të pavarura dhe e ushtronin këtë të drejtë në praktikë; megjithatë, punonjësve civilë të administratës publike dhe anëtarëve të ushtrisë u ndalohet të hyjnë në sindikata. Afro 20 përqind e forcës së punës ishte e sindikalizuar, por anëtarësia e sindikatave ishte në rënie.

Ligji nuk ndalon diskriminimin anti-sindikatë; megjithatë, nuk pati raporte për diskriminim të tillë në praktikë.

b. E Drejta për t'u Organizuar dhe Negociuar Kolektivisht

Qytetarët në të gjitha fushat e punësimit, me përjashtim të anëtarëve me uniformë të forcave të armatosura, oficerëve të policisë, si dhe disa nëpunës gjykatash, kanë të drejtën kushtetuese për t’u organizuar dhe negociuar kolektivisht dhe ligji përcakton procedurat për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve nëpërmjet marrëveshjeve të negociimit kolektiv; megjithatë, sindikatat operonin nga pozita të dobëta. Në praktikë, sindikatat që përfaqësojnë punonjësit e sektorit publik negocionin drejtpërdrejt me Qeverinë. Negociimi i efektshëm kolektiv mbeti i vështirë dhe marrëveshjet ishte e vështirë të zbatoheshin.

Ligji garanton që të gjithë punëtorët, përveç punonjësve të shërbimit civil, ushtrisë në uniformë, policisë, dhe disa zyrtarë gjykatash, kanë të drejtën të kryejnë grevë dhe e ushtruan këtë të drejtë në praktikë. Ligji ndalon grevat që deklarohen haptas se janë politike ose që gjykohen nga gjykatat se janë politike.

Deri në fund të vitit, parku i transportit urban në Tiranë nuk i kishte ripunësuar 10 punonjësit punonjësit që kishin zhvilluar një grevë urie 5-ditore në Prill 2004 në shenjë proteste ndaj shkarkimeve të jashtëligjshme. Drejtori i parkut pretendoi që greva ishte shkelje e kontratës së punësimit të punëtorëve. Megjithëkëtë, Grupi Shqiptar i të Drejtave të Njeriut dhe Avokati i Popullit deklaruan që greva e urisë kishte qenë e ligjshme dhe se drejtori i parkut nuk kishte zbatuar ligjin kur kishte pushuar nga puna punonjësit.

c. Ndalimi i Punës së Detyruar

Ligji ndalon punën e detyruar, përfshi të fëmijëve; megjithatë, praktika të tilla ndodhën (shih seksionet 5 dhe 6.d.).

d. Ndalimi i Punës së Fëmijëve dhe Mosha Minimale e Punësimit

Ligji e përcakton moshën minimale të punësimit në 14 vjeç dhe rregullon sasinë dhe llojin e punës që mund të kryhet nga fëmijë nën moshën 18 vjeç. Fëmijët midis moshave 14 dhe 16 vjeç mund të punojnë në mënyrë të ligjshme në punë me kohë të pjesshme gjatë pushimeve të verës; fëmijët midis moshave 16 dhe 18 vjeç mund të punojnë gjatë gjithë vitit në punë të caktuara të specifikuara. Ministria e Punës vë në zbatim kërkesat e moshës minimale me anë të gjykatave; megjithëkëtë, nuk pati raportime që një zbatim i tillë ndodhi. Inspektimet mbi punën në fabrika gjatë gjysmës së pare të vitit 2004 zbuluan që vetëm 1 përqind e punonjësve ishin nën moshën e lejuar. Megjithatë, inspektorët e punës shqyrtuan vetëm sektorin formal të punës, ndërkohë që shumica e punës së fëmijëve ndodhte në sektorin joformal. Shumica e fabrikave të inspektuara ishin të industrisë së këpucëve dhe tekstileve. Më shumë se 70 përqind e punëtorëve nën moshë ishin vajza. OJQtë raportuan që inspektorët e punës të ngarkuar me investigimin e ankesave për punë të fëmijëve nuk vendosën gjoba a ndëshkime, dhe nuk ndërmorën veprime ligjore kundër atyre që shkelën ligjet mbi punën e fëmijëve.

Qendra Shqiptare për të Drejtat e Fëmijëve (CRCA) vlerësonte se afërsisht 50,000 fëmijë nën moshën 18 vjeç punonin me kohë të plotë ose të pjesshme. UNICEF vlerësonte se 23 përqind e fëmijëve të moshës mes 5 dhe 14 vjeç në vend punonin midis viteve 1999 dhe 2003; fëmijët që konsiderohej se punonin përfshinin ata që kryenin çfarëdo lloj pune të paguar apo të papaguar për dikë që nuk ishte pjesëtar i familjes, që kryenin për më shumë se katër orë punë shtëpie në banesë, apo që kryenin punë tjetër të familjes.

Sipas CRCA, shumica e fëmijëve punëtorë punonin si shitës rruge apo dyqani, lypës, fermerë apo barinj, shpërndarës droge, larës makinash, në fabrika tekstile, dhe bojatisës këpucësh, disa deri edhe 16 orë në ditë. Në Tiranë dhe qytete të tjera, fëmijët – kryesisht romë – punonin si lypës apo shitës cigaresh apo artikujsh të tjerë në rrugë; policia në përgjithësi e injoronte një praktikë të tillë. CRCA gjithashtu vërejti që në Tiranë kishte afro 1,000 fëmijë rrugësh. Një numër gjithnjë në rritje fëmijësh në Tiranë ranë viktimë e prostitucionit dhe formave të tjera të shfrytëzimit. Fëmijët trafikoheshin për shfrytëzim seksual dhe punë të detyruar (shih seksionin 5).

e. Kushtet e Pranueshme të Punës

Nuk kishte një page minimale për punëtorët në sektorin privat. Paga minimale ligjore për punonjësit publikë mbi moshën 18 vjeç ishte afërisht 118 dollarë (11,800 lekë) në muaj, çka nuk ishte e mjaftueshme për të siguruar një standart të arsyeshëm jetese për një punëtor dhe familjen e vet. Paga mesatare për punonjësit publikë ishte afërsisht 213 dollarë (21,325 lekë) në muaj. Sipas Institutit të Statistikave, afro 25 përqind e popullsisë jetonte nën kufirin zyrtar të varfërisë.

Ligjin përcakton një javë 40-orëshe të punës; megjithatë, java faktike e punës u përcaktua me anë të marrëveshjeve individuale apo kolektive. Shumë persona punonin gjashtë ditë në javë. Ligji kërkon pagesën e punës jashtë orarit dhe kohës së pushimit; megjithatë, këto dispozita nuk respektoheshin gjithmonë në praktikë. Qeveria nuk kishte vendosur standarte për një periudhë minimale pushimi në javë, kufi të numrit të orëve punë për një javë, apo sasinë e pagesave për punën jashtë orarit dhe nuk ndalonte orët e tepërta të punës jashtë orarit.

Ministria e Punës dhe Shanseve të Barabarta është përgjegjëse për vënien në zbatim të standarteve dhe rregullave të qeverisë për shëndetin dhe sigurinë në punë; megjithatë, këto standarte në përgjithësi nuk viheshin në zbatim në praktikë. Kushtet faktike të punës ishin shpesh shumë të këqija dhe, në disa raste, të rrezikshme. Gjatë vitit, media raportoi një numër vdekjesh të lidhura me vendin e punës, sidomos në industritë e ndërtimit dhe minierave. Ligji nuk parashikon të drejtën e punëtorëve të rrinë larg situatave të rrezikshme pa rrezikuar punësimin e tyre.